

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-049/13

Prishtinë,

26 Mars 2015

Në çështjen juridike të:

Rt B

S

Pala ankuese

Kundër

T P

P J 25

K

S

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Willem Brouwer anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/60/2010 të datës 22 Shkurt 2010 (lënda e regjistruar në AKP me numrin nr. 40424), pas seancës gjyqësore të mbajtur më 26 Mars 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. **Hidhet si e papranueshme ankesa e R B kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/60/2010 (për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA40424) të datës 22 Shkurt 2010, për shkak se pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 20 Gusht 2007, T P,(këtu e me tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke pohuar se ai është pronar i pronës së kërkuar dhe se kërkon konfirmimin e te drejtës së tij pronësore, ri-posedim dhe kompensim lidhur me ngastrën nr. 2746 me sipërfaqe prej 40ari dhe 7m² që ndodhet në Shirokë, Suharekë, Zona Kadastrale Suharekë(tani e tutje: Prona). Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se ka humbur posedimin e pronës më 11 Qershor 1999 dhe se prona është uzurpuar nga një person i panjohur.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka depozituar pranë AKP dokumentet e mëposhtme:
 - Fletë poseduese nr.84, datë 24 Korrik 2006, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Suharekës me anë të së cilës konstatohet se ngastra objekt kërkesë ndodhet në vendin e quajtur “Shirokë”, Zona Kadastrale Suharekë, Komuna e Suharekës dhe është e regjistruar në emër të T Pç;
 - Kopjen e planit nr.953-2/2001-301, datë 7 Nëntor 2001 lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Suharekës;
 - Leternjoftimin e lëshuar më datë 1 Prill 2002.

Dokumentat e mësipërm janë verifikuar pozitivisht nga Njësia e Verifikimit të KPA-së

Në vijim të procesit të shqyrtimit nga AKP-ja pala përgjegjëse në ankesë depozitoi dhe disa dokumenta shtesë si:

- Historikun e ngastrës të lëshuar nga Zyra e Pronave të Paluajtshme në Prishtinë, i cili vërteton se ngastra 2746 është regjistruar sipas fletës poseduese nr.84 në emër të T P dhe se nuk janë regjistruar ndryshime të tjera për këtë pronë;

- Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.P-72116046-02746-0 datë 29 Tetor 2012, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Suharekes, me anë të së cilës konstatohet se ngastra e kërkuar është regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës
- Vendimin e trashëgimisë nr.36/2002 datë 27 Maj 2002 të Gjykatës Komunale të Suharekës

si dhe dokumente të tjera që nuk janë relevante për marrjen e vendimit.

3. Sipas raportit të notifikimit të datës 27 Korrik 2009, Ekipi i notifikimit kishte bërë verifikimin e vendodhjes së pronës dhe kishte vendosur njoftimin mbi atë tokë. Verifikimi i pronës ishte bërë bazuar në planin kadastral dhe rezultoi tokë bujqësore e kultivuar. Në raportin e notifikimit përmendet se nga kontaktet që ekipi i notifikimit ka marrë me fqinjët në pronë, u mësua se prona ishte uzurpuar nga R B. U bënë përpjekje për të kontaktuar me të, por rezultuan të pasuksesshme për shkak se banorët e zonës nuk ishin bashkëpunues.
4. Asnjë Palë përgjegjëse në kërkesë apo person i interesuar nuk ishte paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive për të kundërshtuar kërkesën para skadimit të afatit prej 30 ditësh.
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronën e kërkuar, me vendimin e saj KPCC/D/A/60/2010 i datës 22 Shkurt 2010 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA40424, ka vendosur të konfirmojë të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës për arsye se ka paraqitur prova të mjaftueshme për të provuar se është pronar i pronës së kërkuar dhe se ka të drejtën e posedimit të asaj pronë.
6. Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më datë 3 Mars 2011. Më datë 7 Prill 2011, pala ankuese i dërgon AKP-së një kërkesë për administrimin e pronës.
7. AKP me vendimin e saj të datës 3 Gusht 2011 kishte vendosur ta vendos pronën nën administrim pronësor të AKP-së.
8. Më datë 11 Janar 2013 AKP-ja lëshon një urdhër dëbimi për uzurpuesin e pronës në fjalë.
9. Vendimi i është dorëzuar Palës ankuese me datën 24 Janar 2013.

10.Më datë 25 Janar 2013 Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

11.Së bashku me ankesën pala ankuese kishte paraqitur dokumentet (kopjet) vijuese si prova :

- Vërtetim nr.952-20/2013, datë 21 janar 2013 për historikun e ngastrave nr.1357 dhe nr.2746 të lëshuar nga Drejtoria e Sherbimeve Pronësore Juridike, qe vërteton se ngastra 2749 është në emër te T P (nëna e palës përgjegjëse në ankesë)
- Kontratë nr.224/62, datë 1 Nëntor 1961 për blerjen e ngastrës nr.1357 e lidhur midis T P (nëna e palës përgjegjëse në ankesë) dhe R B (babai i palës ankuese), e verifikuar nga gjykata
- Etj.

Ankuesi ka paraqitur dhe një sërë dokumentesh, të cilat nuk janë relevantë për zgjidhjen çështjes.

Pretendimet e palëve

12. Pala ankuese kundërshton vendimin e KKPK-së me arsyetimin se vendimi është marrë në kushtet e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në ankesën e saj pala ankuese pretendon se KKPK-ja ka tejkalluar kompetencat e saj duke vendosur për kërkesën, sepse kërkesa e paraqitur nga kërkuesi në KPA është kontestuese, pasi për pronën në fjalë është duke u zhvilluar procedura për vërtetimin e pronësisë në gjykatë, i iniciuar nga pala ankuese, R B. Pala ankuese shton se kërkesa e paraqitur para KPA-së nuk përfshin rrethanat që kanë lidhje me konfliktin e armatosur. Për sa i përket pronës objekt kontesti, pala ankuese sqaron se prona ne fjalë është ngastra nr.1375, numri i së cilës ka ndryshuar në 2746 si pasojë e ndryshimeve të bëra pas aerofotografimit dhe se ai është në posedim të saj që prej vitit 1961 kur e ka fituar pronësinë mbi të nëpërmjet kontratës së shitblerjes së lidhur midis T P (nëna e palës përgjegjëse në ankesë) dhe R B (babai i palës ankuese).

13.Pala përgjegjëse në ankesë, në përgjigjen e saj ndaj ankimit deklaron se ankesa e palës ankuese nuk qëndron për arsye se pala ankuese nuk ka qenë palë ne procedurën në shkallë

të parë dhe se ngastra e pretenduar prej tij, nuk është e njëjtë me ngastrën objekt kontesti. Në ankesë bëhet fjalë për ngastrën 1357, ndërsa objekti i kontestit është ngastra no.2746.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

14. Ankesa e R B, është e papranueshme, për arsye se nuk ka qenë palë në procedurën në shkallë të parë pranë KKPK-së.
15. Gjykata Supreme ka juridiksion për të shqyrtuar ankesën.
16. Sipas nenit 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftim i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës me vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore.
17. Neni 10.1 i Ligjit. 03/L-079 parashikon që pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i po të njëjtit ligj thekson se *“çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë është palë ... me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria Ekzekutive [...]”*.
18. Vetëm pala në procedurën në shkallë të parë ka të drejtë të paraqes ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Sipas juridiksionit të Kolegjit të AKP-së të Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm nga ky rregull ndodh vetëm nëse dhe kur personi që mund të pretendojnë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka qenë në dijeni për kërkesën e paraqitur në AKP për shkak të mungesës së njoftimit të duhur dhe në këtë mënyrë nuk është në gjendje që të paraqes njoftimin për pjesëmarrjen.

19. Në rastin konkret, Gjykata Supreme vëren se sipas fakteve të përmendura më sipër, pala ankuese i ka patur të gjitha mundësitë për të marrë dajeni për zhvillimin e procedurës në shkallë të parë, pasi njoftimi ka është bërë në mënyrën e duhur, duke u vendosur shenjat përkatëse në ngastrën në fjale. Pala ankuese duke qenë në shfrytëzim dhe posedim të ngastrës lehtësisht e ka vënë re njoftimin, por megjithatë nuk ka marrë pjesë në procedurën përpara instancës së parë për të shprehur interesin e saj ligjor. Gjithashtu, pas marrjes së vendimit nga ana e KKPK-së prona është vendosur nën administrim të AKP-së dhe për këtë janë vendosur njoftimet përkatëse, por megjithatë pala ankuese nuk është interesuar pranë AKP-së. Për më tepër, në ankesën e tij nuk jep asnjë arsye se përse nuk ka marrë pjesë në procedurë përpara shkallës së parë.
20. Gjykata Supreme e konsideron të nevojshme të sqarohet fakti se edhe nëse pala ankuese do të kishte qenë palë në instancën e parë, ankesa është e papranueshme pasi në ankimin e tij ai pretendon pronësinë mbi ngastrën nr.1357, pra kërkon njohjen e pronësisë mbi një tjetër ngastër. Lidhur me pretendimet e tij se kjo ngastër ka ndryshuar numër si pasojë e ndryshimeve që kanë pësuar regjistrat kadastralë pas aerofotografimit, ai nuk ka paraqitur ndonjë dokument të vlefshëm për të provuar pretendimin e tij. Në anën tjetër, pala përgjegjëse në ankesë ka depozituar një vërtetim nr.952-20/2013, datë 21 janar 2013 të lëshuar nga Zyra Kadastrale për Pronat e Paluajtshme të Prishtinës në Krusevac, që vërteton se pas aerofotografimit të bërë në vitin 1959, për parcelën nr.2746 nuk ka ndryshime të pasqyruara në regjistër. Ky dokument vërteton se numri i ngastrës nuk ka pësuar ndryshime dhe se pretendimi i palës ankuese nuk qëndron. Për të vërtetuar sa me sipër pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.P-72116046-02746-0 datë 29 Tetor 2012, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Suharekes, me anë të së cilës konstatohet se ngastra e kërkuar është regjistruar në emër palës përgjegjëse në ankesë.
21. Përveç sa me sipër, duke qenë se objekt i kontestit është ngastra nr.2746, pala ankuese në ankesën e saj nuk mund të kërkojë me shume se sa është kërkuar në procedurën në të cilën është marrë vendimi objekt ankimi apo të ndryshojë objektin, pasi sipas nenit 258, parag.1 të LPK-se është i ndaluar ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo shqyrtimit kryesor.

22. Në këto kushte, duke qenë se ankesa është e papranueshme, Gjykatës Supreme nuk i duhet të vendos për meritat e ankesë.

Konkluzion

23. Bazuar ne faktet dhe arsyetimin e mësipërm, ankesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në përputhje me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195 par.1, nën-par (a) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Prandaj, Kolegji vendosi së në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

24. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Esmat Erterzi, Gjyqtare i EULEX-it

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it